

Dr. Sejdi Gashi  
Prof. Dr. Mustafa Ibrahim

## PARALELE HIDRONIMESH MIDIS PELAGONISË DHE PODGURIT<sup>(1)</sup>

### Hyrje

Mikrotoponimet, si përmendore të kujtesës njerëzore kanë një rëndësi të veçantë për autoktoninë e një populli dhe mënyrën e të jetuarit të tij. Rëndësi të veçantë kanë ato edhe për disiplinat e tjera gjuhësore dhe jashtëgjuhësore si për dialektologjinë, gjuhësinë, historinë etj.

Vendbanimet shqiptare të rajonit të Pelagonisë dhe atij të Podgurit janë shumë të pasura me mikrotoponime, sepse duke u gjendur në një hapësirë të izoluar nga folësit e tjerë shqiptarë të shqipës, kanë ruajtur shumë fjalë të rralla dhe mikrotoponime, të cilat shumë rrallë ose aspak nuk hasen në të folmet e tjera shqipe.

Mikrotoponimet, përkatësisht hidronimet e këtyre anëve janë analizuar edhe nga aspekti dialektologjik, duke treguar tiparet kryesore të këtyre të folmeve me shembuj konkret. Në këtë fushë të të folmeve janë paraqitur edhe ndikimet e gjuhëve tjera (të gjuhës maqedonase, serbe, turke dhe gjuhëve të tjera), me të cilat këto të folme janë në kontakt dhe, lidhur me këtë është bërë një qasje e veçantë e interferencës dhe bilingualizmit si dhe implicititetit të tyre. Pra, hidronimia e këtyre viseve shqiptare na del me peshë dhe interes të shumanshëm, përgjithësisht për gjuhësinë shqiptare, e në veçanti për dialektologjinë, sepse ky rrip tokash, kundruar gjeografikisht, etnikisht, historikisht dhe në aspektin dialektor, përbën një vazhdimësi të natyrshme të truallit etnik shqiptar.

Filluar nga kjo vijë gjurmimesh, të truallit të lëndës leksikore të këtyre anëve, do theksuar se trevat e sipërpërmendura paraqesin një sistem zonash margjinale konservacioni, që dallohen për visarin

<sup>1</sup> Këtu nënkuptohet vetëm komuna e Istogut me fshatrat e saj.

e pasur popullor, të larmishëm dhe arkaik <sup>(2)</sup>që, përmbajnë një mal të tërë leksemash për shënjimin e ujërave dhe rrjedhave ujore, përkatësisht të hidronimeve. Nga ana tjetër, të bien në sy edhe një mal i tërë materialesh të tjera lëndore e shpirtërore, me vlerë të shumanshme. Veç të tjerash, kjo lëndë leksikore e këtyre skajeve, pothuajse në mënyrë tërësore, përveçohet për origjinalitetin, ngjyresën e ligjërrimit popullor, figuracionin stilistiko-gjuhësor, lashtësinë dhe autoktoninë shqiptare.

Vështruar historikisht, pra në rrafshin e toponomastikës historike të Pelagonisë, por edhe të Podgurit <sup>(3)</sup>, elementi shqiptar dikur shtrihej edhe në shumë fshatra tjera, sot të banuara me popullsi sllave, përkatësisht në to aty –këtu sot kanë mbetur vetëm gjurmë historike toponomastike dhe patronimike si fosile të procesit të asimilimit të këtij etnikumi në elementin maqedonas dhe atë serb <sup>(4)</sup>.

Megjithëkëtë autoktonia shqiptare në Pelagoni dëshmohet qysh herët, në dokumentet e shkruara së paku nga viti 1336, pas fitores së serbëve ndaj grekëve, ku po në këtë vit, në rrethin e Prilepit përmendet termi Arbanas. Aso kohe Stefan Dushani e kishte pushtuar Prilepin dhe si qendër të zhupanisë së tij zgjedh manastirin Treskavec dhe më pas lëshon tri dekrete, nga të cilët është ruajtur ai i vitit 1336 <sup>(5)</sup>. Këto shkresa më 1865-n i zbuloi dhe i përktheu nga sllavishtja e vjetër St. Novakoviç. <sup>(6)</sup> Këtë dekret në mënyrë origjinale në veprën e tij e boton edhe Eniçerev <sup>(7)</sup>. Në këtë dekret thuhet:

*“Sheshi i shkretë i Drenovcit, nga ai gjysma dhe gjysma nga fushat dhe malet edhe nga Arbanasi”,*

<sup>2</sup> Mehmet Ahmetaj, *Fjalor i të folmeve shqiptare në Mal të Zi*, Instituti Albanologjik-Prishtinë, 1996, f.9.

<sup>3</sup> Nga rajoni i Podgurit në këtë punim kemi përfshirë vetëm komunën e Istogut me fshatrat e saj.

<sup>4</sup> Fjalën e kemi për fshatrat e Podgurit (Istogut) si: *Belicë, Cërkohez, Dobrushë, Kosh, Llukavc i Thatë, Osojan, Serbobran, Tuqep, Veriq, Veriq i Ri*.

<sup>5</sup> Jovan Haxhi-Vasiljeviç, *Prilep i njegova okolina*. Beograd 1902, f.97.

<sup>6</sup> St. Novakoviç, *Srpske starine u Makedoniji – Bele`ke s putovama Arhimandrita Antonina iz 1865 ne spomenik Srpske Kraqevine Akademije*. IX; në GSND XLI (f.258-361).

<sup>7</sup> Nikola Gançev Eniçerev, *Vizpominani i bele`ki*. Sofia 1906, f.333.

d.m.th. manastirit të Treskavecit i dhurohen pasuri të patundshme edhe nga fushat dhe malet e fshatit Arbanas”, fshat që sot nuk ekziston në topografinë e shtetit.

Shumë dokumente turke, sllave e të tjera, dëshmojnë për prezencën e elementit shqiptar, i cili në vazhdimësi jeton që nga mesjeta e deri më sot në trevat e tyre autoktone. Kjo mund të dëshmohet edhe me termat e tjerë onomastikë, siç janë topikët: Arbanas, Arbanash dhe Arnaut, të cilët i ndeshim në disa lokalitete dhe vendbanime të trevës së Prilepit, si: *Arbanasi* – kullosë kodrinore në Prilep,<sup>(8)</sup> *Arbanasi* – kullosë në vend kodrinor në fshatin Dupjaçan,<sup>(9)</sup> *Arbanasi* – lokalitet afër fshatit Nebregovë të Prilepit. Këtu gjendet “Latinska Crkva”, të cilën Blazhe Koneski e lidh me elementin etnik shqiptar, ndërsa “latin” i quan shqiptarët katolikë<sup>(10)</sup>, *Arnaut Xhamia* – xhami në Prilep<sup>(11)</sup>, që sot nuk ekziston, *Arnautska Maalla* – f.Golemi Konjari, *Arnaut Mahalla* – mëhallë në Prilep<sup>(12)</sup>, *Arnaudska Zemja* në anë të Prilepit<sup>(13)</sup> etj.

### Detyrat e leksikografisë shqiptare

Sot, leksikografia, përkatësisht leksikologjia shqiptare, shtron para nesh, një varg çështjesh të ngutshme gjuhësore, që nuk presin, ndaj sa më parë i duhet hyrë, jo vetëm gjurmimit e pasqyrimin të leksikut të këtyre anaviseve shqiptare, me hope gjithnjë e më të shpejta.

Parë nga aspekti krahasues, Pelagonia e Maqedonisë dhe Podguri i Kosovës, përbëjnë një situatë mjaft komplekse, me shumë të përbashkëta, por njëkohësisht edhe me shumë dallime. E përbashkëta është se këto dy këto treva shqiptare kanë një rrugëtim historik të ngjashëm, me shumë zhvillime e tendenca prapavajtëse. Nga ana tjetër, dallimi qëndron në faktin se Pelagonia gjendet në një shtet ku popullsia shqiptare nuk është shumicë, kundruall Podgurit të Kosovës, ku shqiptarët përbëjnë

<sup>8</sup> TD – *Turski dokumenti* br..4 (1467-1468), Skopje, 1971.

<sup>9</sup> O.Ivanova, *vep. e cit.* f.25.

<sup>10</sup> Blazhe Koneski, *Makedonski mesta i imina*, Skopje 1991, f.30.

<sup>11</sup> Georgi Traičev, *Grad Prilep*. Sofia 1925, f.8-11.

<sup>12</sup> Po aty.

<sup>13</sup> Milladinovci, *Zbornik* 242, 373, 445, (1881-1961), Skopje 1962.

më shumë se 95% të numrit të përgjithshëm të popullsisë, por që deri para pak vitesh gjendeshin të shtypur e të robëruar nga aparati shtetëror serb.

Kur kemi të bëjmë me politikat gjuhësore që ka ndjekur Maqedonia në rrymë të kohëve, duhet përmendur fakti se është pikërisht ky shtet që bëri përpjekjet e para për formimin e të ashtuquajturve komisione republikane për standartizimin e emërve dhe e ne do të thoshim “komisionin republikan për sllavizimin e emërve”. Përkundër këtij fakti, “filologjia shqiptare, ndryshe nga filologjia sllavo-maqedone, ende nuk u ka kushtuar vëmendjen e duhur fqinjëve të vet (në të gjitha përmasat e duhura: historike, kulturore, etno-psikologjike, gjuhësore etj.) dhe për më tej as në periudhën e parë (kur mundësitë e saj ishin të kufizuara) as në periudhën e dytë (kur i ka pothuajse të gjitha instrumentet bashkëkohore), nuk u ka dhënë përgjigjen e duhur rezultateve të dijes maqedone, për përmasën e kulturës materiale e shpirtërore të shqiptarëve. Pra, fqinjët tanë maqedonë për shqiptarët, kanë gjuarmuar, mbledhur, sistemuar, studiuar e sintetizuar në dosje, në arkiva, në tryeza të fshehta e të hapura, në konferenca kombëtare e ndërkombëtare, në vëllime populuarizuese, shkencore e ekstrashkencore, në vepra politike e diplomatike, në vepra sintetike e enciklopedike, një lëndë të pasur materiale e studimore, siç na thotë edhe Jokli, për më se dy shekuj, ndërsa në shekullin e fundit dhe në një përmasë më aktive. Vetëm në gjysmëshekullin e fundit, gjejmë reagime kryesisht individuale, dhe madje individualiste për autorë a vepra të studiuesve maqedonë<sup>(14)</sup>.

Gjendja ekzistuese gjithandej trevave shqiptare në Maqedoni, dëshmon se organet politike dhe shtetërore të atjeshme, ende po ndërmarrin veprime aspak demokratike në lidhje me shkrimin dhe shqiptimin e emrave të vendeve (të qyteteve, të fshatrave, të maleve, të fushave dhe të lumenjve) në gjuhën shqipe në këtë shtet, sepse sipas tyre, kurdo e kudo, toponimia dhe mikrotoponimia e kësaj republike edhe në gjuhën shqipe duhet të shkruhet, të shqiptohet sikundër shkruhet dhe shqiptohet në maqedonishte. Kështu, për shembull, Shkupi edhe në shqipen duhet të shkruhet dhe të shqiptohet Skopje, Tetova-Tetovo, Ohri-

<sup>14</sup> Begzad Baliu, *Hulumtime albanologjike, "Era"*, Prishtinë, f.269-270.

Ohrid, Kërçova-Kiçevo<sup>(15)</sup> e të tjera të ngjashme. Pra, dallimet e natyrshme gjuhësore shqip-maqedonishte në shkrimin dhe në shqiptimin e toponimeve dhe mikrotoponimeve të Maqedonisë nëpërmjet shqipes dhe maqedonishtes, i janë nështruar plotësisht shikimit politik, të frymëzuar prej disponimit aktual ndaj kulturës shqiptare.

Pra, siç mund të vihet re, përdorimi i disa toponimeve dhe mikrotoponimeve shumëgjuhëshe në Maqedoni, ka filluar të bëhet problem me karakter administrativ e politik. Në të vërtetë, po shfaqen tendenca dhe përpjekje të individëve e të grupeve të individëve, për t'i unifikuar toponimet e mikrotoponimet shumëgjuhëshe, në toponime e mikrotoponime njëgjuhëshe e *“nga kjo kuptohet kryesisht heqja me dhunë e me masa administrative e njërit emërtim ekzistues apo toponimit në dobi të emërtimit apo toponimit të gjuhës tjetër të favorizuar”*.<sup>(16)</sup>

Nga ana tjetër, për sa i përket Podgurit si trevë e veçantë etnogeografike e Kosovës, e, saktësisht idiomës gjuhësore të Istogut si pjesë përbërëse e kësaj treve, mund të thuhet se për shkak të shtrirjes gjeografike, është e folme relativisht e izoluar, prandaj nuk është prekur aq shumë nga gjuha letrare kombëtare, por as nga faktorë jashtë shqipes dhe kështu, prandaj janë ruajtur thesare të paçmuara gjuhësore, përfshirë këtu edhe pjesë të konsiderueshme të onomastikës, përkatësisht të hidronimisë së këtyre anaviseve shqiptare.

E vlerësojmë si shumë shumë të rëndësishtme ta regjistrojmë fjalësin hidronimik të këtyre anëve, sepse po që se humbet apo transformohet ai, do të bëjë, që edhe brezat e ardhshëm ta kenë të vështirë apo të pamunduar të depërtojnë në thellësitë e mijëvjeçarëve, për faktin se transformimet gjuhësore po ndodhin me shpejtësi të madhe.

Në pjesën e mëposhtme të këtij punimi do të vëmë në pah disa paralele hidronimike midis rajonit të Pelagonisë dhe Podgurit, përkatësisht Istogut me rrethinë. Hidronimet e poshtëshënuara i kemi sistemuar sipas prejardhjes (origjinës) gjuhësore të tyre.

<sup>15</sup> Rexhep Qosja, *Atentate mbi kulturën*, Gjuha shqipe, 1/1987, Instituti Albanologjik-Prishtinë, f.9-12.

<sup>16</sup> Latif Mulaku, *Toponimet shumëgjuhëshe në Kosovë*, në: Gjuha shqipe, 1/1987, Instituti Albanologjik-Prishtinë, f.34-35.

a) Hidronime me gurrë autoktone shqipe

PELAGONIA	PODGURI (ISTOGU)
BRRAKË: 'vorbull uji'. <sup>17</sup> Brraka a Cër, Bor Çeshmja e Brrakës kr Bor	BRRAKË: 'vorbull uji'. Brrakât ve Kal.
BUÇALLË 'ujëvarë, vend ku buqet uji': Buçalla li Cër	BUÇALLË 'vend ku buqet uji': Buçalla ve Bel. Burimi i Radavcit lu Rad
GURRA: Ka Gaurra a Des	GURRA: Te Gurrat e Bardha ve Cërr,Sush
GEREN 'ara që mbajnë lagështi' Gernik ve Deb	UJTINA' toka që mbajnë lagështi' Ujtinat a Llug,Pa Baltaku a Car., Ist.P., Lluk. B
HURDHË-A: 'Vend me lloq, me batak': Aurdha e Bogdanit a Llzh	BALTAKU' Vend me lloq, me baltë" Baltaku ve Star,Llug.
KORITË: Koraita ve Gos	
KROJ: Kroj i Elezit kr Jab Kroj i Ftohet kr Jab	KRU, KROJE Krojet ckr Vre Krojet e Kçija kr Uç
LERA 'Vend me lloq': Liera <sup>18</sup>	MELLI: SHT-A:' Vend me lloq' Mellishta ve Tom, Kov, Star.
LIGATA: "vend i lagësht": <i>Ligata</i> (lag+atë) <sup>19</sup> Ligata a,li Cër, Alld Ligurçe a Ner	
LIQE-NI: Ke Liqeni a Des	LIQENI: Liçeni i Moknës liq Cërr Liçeni i Sy:lzeçirit liq Orrob Likeni i Shatrajve liq Tom,Cërr

<sup>17</sup> Emri i këtij toponimi është dëshmuar që nga 1272-i te Sebastus Paulus Bracca, (Acta et diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia, bot.L.de Thlloczy, e Jirecek E. de Sufflay, Vindobonae 1913 (T.I), f.265), haset edhe më vitin 1485 në fshatin Shestan/Gjon Brraka, Petri b.Brrakut, Grava/Podgoricë (defteri i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485, bot.S.Pulaha, T.1974, f.321,334.

<sup>18</sup> Sipas Eqrem Çabejt (shih Studime gjuhësore I, Rilindja, Prishtinë 1976, f.315), emri i këtij toponimi lidhet me fjalën shqipe "zhul, zdral" dm.th. rërë, llaç.

<sup>19</sup> Bahtiar Kryeziu, Mikrotoponimia e fshatit Rogaçicë, në Gjurmime albanogjike – SSHF, Prishtinë XIII-1983,f.294.

LLAK-U - 'ara që kanë qenë vende moçalike'. Sredullaku                      li    Pesh	KJASINA: ' 'ara që kanë qenë vende moçalike' Kjasinat n'Rrahe                      v    Llug.
LLOM-I 'llumë, gropë a madhe me ujë të ndenjtur e të ndotur': Llomb i Zerkës                      kr    Jab Llumba                                      a    Cër	
MOÇALISHTË: Moçka                                      a    Cër	MOÇALISHTA: Mokna                                      m    Cerk
PËRRUA: Te Proja                                      Pre Ke Pruoj                                      kr    Llazh Ku Përzien Prenjt                      m    Ner	PRRU: Projet                                      përr Vre, Shuh, Kal. Prroni i Bicit                              përr    Stud
TINJË 'vend me rërë dhe ujë': Ke Tinjët                                      ve    Cër Tinjët    kr    Cër	DRI-NI: Drini i Vogël                              lu    Star Lugu i Madh                              lug    Vre
SHUPURKË 'burimth': Shupauri                                      kr, kod    Bell, Bor	KROJZI' burime të vogla uji': Krojzit                                      kr    Lubozh Banishori                                      kr    Kërn
UJË: Ke Ujti i Diellës                      ve    Cër Uji i Ftoftë                                      kr    Aild	UJË: Uji i Maxhupit                              kr    Pol Uji i Nxe: t                                      bur    Ba
VIJË-A: VijaluCër	VIJË: Vija e madhe                              përr    Prig
ZALL: Ke Zalli i Gostirazhit    ku    Cër Ke Zalli i Zekmanit    lu    Cër Zallnit e Strajs                      lu    Cër	LUMË: Lumi Istog                              lu    Ist, Lluk, Llug, Zall, Lumi Çaush                              lu    Ist.P, Ist, Drag.

### b) Hidronime me gurrë sllave

<b>PELAGONIA</b>	<b>PODGURI (ISTOGU)</b>
BARA 'hurdhë' (<sllav. <i>bara</i> ) Bara                                      a    Deb Baraqaica                              a    Sog	BARE 'hurdhë' (<sllav. <i>bara</i> ) Bare                                      ve    Ist, Cërr
BLLAT 'vend me baltë' (<sllav. <i>blato</i> ) Bllatli Zhit	
DOLL 'lumë i vogël' (<sllav. <i>дол</i> ): Javevdoll                              m    Pre Kllajneci i Turskidollit    kr    Sog	
EZERO 'liqe' (< sllav. <i>ezero</i> ): Ke Ezerol                                      u    Bor Ke Ezeroja                              a, lu    Cër, Deb	



<p>ÇESHMA 'krua' (&lt; tur. <i>çesme</i>):</p> <p>Busheva Çeshma           kr   Zhit</p> <p>Çeshma e Amitit           kr   Alld</p>	<p>ÇESHMJA 'krua' (&lt; tur. <i>çesme</i>):</p> <p>Çeshmja                       kr   Bel</p> <p>Çeshmja te shkolla       kr.   Jab. V</p> <p>Çeshmja te xhamia       kr.   Ist</p>
<p>SULI 'vend me ujë' (&lt; tur. <i>sulu</i>)</p> <p>Ke Sulishtetkod Bell</p>	
<p>SHAMAK 'kënetë e mbushur me kallamë' (&lt; tur. <i>şamak</i>):</p> <p>Ke Shamaku           li   Deb, Bor, Sog</p> <p>Shamaku               li   Cër</p> <p>Audha e Shamaku   tu   Cër</p>	
<p>BUNAR:</p> <p>Bunari i Alilit           kr   Pesh</p> <p>Bunari i Caifës       kr   Sazh</p>	<p>BUNAR:</p> <p>Bunari i Avdi:s               kr   Dre</p>
<p>ENDEK (&lt; tur. <i>endek</i>):</p> <p>Ke Endeku i Shaqir Kasos ve Cër</p>	

#### d) Hidronime –ndërkombëtarizma

<p>PELAGONIA</p>	<p>PODGURI (ISTOGU)</p>
<p>REZERVUAR:</p> <p>Rezervari i Boreinës   m   Zhit</p>	<p>REZERVA:R:</p> <p>Te Rezervari i Burimit   ve   Ist</p>
<p>KANAL:</p> <p>Livadhët nën Kanall   li   Pre</p>	<p>KANALL:</p> <p>Kanalli i Prigod's           lu   Vre, Prig.</p> <p>Arat nën Kanall           ve   Tom, Prig, Vre</p>

Shprehur në mënyrë statistikore, hidronimia e Pelagonisë ka këtë pasqyrë:

41 leksema, të cilat për nga prejardhja e tyre gjuhësore kanë këtë strukturë:

- 19 ose 46.3 % nga gjuha shqipe (*brrakë, buçallë, gurra, geren, hurdhë-a, koritë, kroj, lera, ligata, liqe-ni, llak-u, llom-i, moçalisht, përrua, tinjë, shupurkë, ujë, vijë-a, zall*);
- 14 ose 34.1 % janë maqedonase (*Bara, bllato, doll, ezero, izvor, kall, klladenec, kopanka, llag, peralo, reka, topillë, sllatina, voda*);
- 6 ose 14.6 % janë turke (*batak, çeshma, suli, shamak, bunar, endek*);
- 2 ose 4.8 % janë nga gjuhë ndërkombëtare (*rezervuar dhe kanal*).

Nga ana tjetër, hidronimia e Podgurit (Istogut), parë nga rrafshi i të dhënave statistikore, ka këtë pasqyrë:

- 27 leksema, të cilat për nga prejardhja e tyre gjuhësore kanë këtë strukturë:
- 16 ose 31 % nga gjuha shqipe (*brrakë, buçallë, gurra, ujtina, baltak, kroje, mellishta, liqeni, kjasina, moçalishta, prroni, drini, kroji, ujë, vijë, lumë*);
- 5 ose 10% nga serbishtja (*bare, izvor, çulina, topillë, voda*);
- 3 ose 6% nga turqishtja ose gjuhët orientale (*batak, çeshmja, bunar*);
- 2 ose 4% ndërkombëtarizma (*rezervar, kanall*).

### Përfundime

Nga tërësia që shtjelluam në këtë punim, me plot gojën mund të pohohet se kundruar nga aspekti krahasimtar, hidronimia me gurrë shqipe nga rajoni i Pelagonisë dhe nga Podguri u ka bërë ballë stuhive të kohës, ndonëse te një numër leksemash bie në sy ndikimi i sllavishtes dhe i turqishtes, por edhe i gjuhëve të tjera orientale.

Marrë në përgjithësi, mbi 60% e apelativave hidronimikë të Pelagonisë dhe të Pogurit (Istogut) janë të gurrës autoktone shqipe, që rrojnë sot e gjithë ditën. Prandaj, hulumtimi, regjistrimi dhe studimi i kujdesshëm i hidronimeve ka rol dhe peshë të veçantë, sepse na ndihmon për t'i zgjeruar njohuritë tona në shumë fusha e disiplina të tjera shkencore, pra edhe përtej gjuhësisë, kurse vështruar vetëm nga rrafshi gjuhësor, mikrotoponimet, përkatësisht hidronimet, na ndihmojnë që të ndriçojmë çështje dhe probleme gjuhësore nga më të ndryshmet, sidomos na mundësojnë të hedhim dritë mbi "rrënoja" gjuhësore e historike nga e kaluara e popujve, në rastin tonë mbi të kaluarën e popullit shqiptar, sidomos në ato raste kur mungojnë burimet shkrimore-historike, ose kur ato ekzistojnë, por "heshtin".

Siç u tha edhe më lart në këtë punim, gjurmët onomastike që kanë krijuar shqiptarët, në rrymë të moteve janë me rëndësi të shumëfishtë, jo vetëm për gjuhësinë, por edhe për shkencat e tjera, bie fjala për historinë, gjeografinë, etnografinë, gjeodezinë etj., prandaj onomastika me të gjithë përbërësit e vet duhet të

studiohet dhe duhet të jetë në shërbim të albanologëve e të albanologjisë.

*Shkurtesa për fshatrat:*

PELAGONIA			PODGURI (ISTOGU)		
Nr.	Shkurtesa	Fshati	Nr.	Shkurtesa	Fshati
1.	Cër	Cërnilishtë	1.	Ba.	Baica
2.	Des	Desovë	2.	Banj.	Banja
3.	Gos	Gostirash	3.	Bel.	Belica
4.	Pesh	Peshtalevë	4.	Bell.	Bellopoja
5.	Deb	Debresh	5.	Car.	Caralluka
6.	Llazh	Llazhan	6.	Cer.	Cerkolezi
7.	Zhit	Zhitoshë	7.	Cerr.	Cerca
8.	Jak	Jakrenovë	8.	Dob.	Dobrusha
9.	Sazh	Sazhdovë	9.	Drag.	Dragoleci
10.	Bell	Bellushinë	10.	Dre.	Dreja
11.	Bor	Borinë	11.	Dub. V.	Dubova e vogël
12.	Alld	Alldançe	12.	Dubr.	Dubrava
13.	Ner	Nerovë	13.	Gurr.	Gurrakoci
14.	Pre	Presill	14.	Ist.	Istogu
15.	Sog	Sogle	15.	Ist. P.	Istogu i Poshtëm
16.	Jab	Jabollçishtë	16.	Kal.	Kaliçani
<p><i>Shkurtesa:</i></p> <p>Konfiguracioni i vendeve dhe fshatrave</p> <p>a - ara  b - bunar  bu-burim  m - mal  kod - kodër  kr - krua  ku - kullosë  li - livadh  lu - lumë  për - përua  mu - mulli  u - udhë  ur - urë  g - gurë  kor - kori  d - dru</p>			17.	Kam.	Kamenica
			18.	Kash.	Kashica
			19.	Kërn.	Kërnina
			20.	Ko.	Koshi
			21.	Kov.	Kovraga
			22.	Lub.	Lubova
			23.	Lubozh.	Lubozhda
			24.	Llug.	Llugat
			25.	Lluk. B.	Llukavci i begut
			26.	Lluk. Th.	Llukavci i thatë
			27.	Mojst.	Mojstiri
			28.	Muzh.	Muzhevina
			29.	Orrob.	Orrobërda
			30.	Oso.	Osojani
			31.	Pad.	Padalishta
			32.	Pol.	Polana
			33.	Prek.	Prekalla
			34.	Prig.	Prigoda
			35.	Rak.	Rakoshi
			36.	Ser.	Serbobrani
37.	Sin.	Sineja			
38.	Stad.	Staradrani			
39.	Stud.	Studenica			
40.	Suh.	Suhogërlla			

41.	Shal.	Shalinovica
42.	Shush.	Shushica
43.	Tom.	Tomoci
44.	Trub.	Trubuhoci
45.	2Tuq.	Tuqepi
46.	Uç.	Uça
47.	Ver.	Veriqi
48.	Ver.R.	Veriqi i Ri
49.	Vre.	Vrella
50.	Zab.	Zabllaçi
51.	Zall.	Zallçi
52.	Zhak.	Zhakova

### ***Bibliografia:***

- Ahmetaj, Mehmet. *Fjalor i të folmeve shqiptare në Mal të Zi*, Instituti Albanologjik-Prishtinë, 1996.
- Ahmetaj, Mehmet. *Gjurmime onomastike*, Instituti Albanologjik-Prishtinë, 2009.
- Baliu, Begzad. *Gjendja e toponimisë shqiptare në Ballkan*, "Era", Prishtinë, 2004.
- Baliu, Begzad. *Onomastika e Kosovës (ndërmjet miteve dhe identiteteve)*, "Era", Prishtinë, 2008.
- Baliu, Begzad. *Onomastikë dhe identitet*, "Era", Prishtinë, 2012.
- Baliu, Begzad. *Hulumtime albanologjike*, "Era", Prishtinë, 2015.
- Qosja, Rexhep. *Atentate mbi kulturën*, Gjuha shqipe, 1/178, Instituti Albanologjik-Prishtinë, 1978.
- Gashi, Sejdi. *Areali gjuhësor i Istogut me rrethinë*, Disertacion doktorate në dorëshkrim, Universiteti i Evropës Juglindore, Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit (Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe), Tetovë, 2017.
- Ibrahim, Mustafa. *E folmja shqipe e rrethit të Prilepit dhe Krushevës*, "Interlingua", Shkup, 2005.
- Ibrahim, Mustafa. *Fjalë dhe shprehje popullore nga rrethi i Prilepit, Krushevës dhe Velesit*, "Interlingua", Shkup, 2007.
- Ibrahim, Mustafa. *Mikrotoponimet në vendbanimet shqiptare*

*të rrethit të Prilepit, Krushevës dhe Velesit, "Interlingua", Shkup, 2010.*

- Ismajli, Rexhep. *Disa çështje të onomastikës shqiptare të Mesjetës*, në: Studime filologjike, nr.4. Prishtinë, 1978.
- Koneski, Blazhe. *Makedonski mesta i imiëa*, Skopje, 1991.
- Kryeziu, Bahtijar. *Onomastika e Hashanisë*, Prishtinë, 2000.
- Milladinovci. *Zbornik* 242, 373, 445, (1881-1961), Skopje, 1962.
- Mulaku, Latif. *Ndryshimet gjuhësore të disa toponimeve në GJA - SSHF, 19-1989*, Prishtinë, 1989.
- Murati, Qemal. *Fjalor toponomastik i tërthoreve shqiptare të Maqedonisë*, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Seminari i Albanologjisë, 2008.
- Novaković, St. *Srpske starine u Makedoniji - Bele`ke s putovama Arhimandrita Antonina iz 1865 ne spomenik Srpske Kraçevine Akademije. IX; në GSND XLI /Osmani, Jusuf. Vendbanimet e Kosovës, Burimi (Istogu), Vëllimi 12, Prishtinë, 2004.*
- Vasiljeviç, Haxhi Jovan. *Prilep i njegova okolina*, Beograd, 1972.